



UNMIK/DIR/2008/5
5 maj 2008

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2008/5

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2006/50 MBI
ZGJIDHJEN E KËRKESAVE LIDHUR ME PASURINË E
PALUAJTSHME PRIVATE, DUKE PËRFSHIRË PRONËN
BUJQËSORE DHE KOMERCIALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas neneve 6.3 dhe 21 të Rregullores së Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 2006/50 të datës 16 tetor 2006, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pasurinë e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe

Duke marrë parasysh nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 në lidhje me nenin 16 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10 të datës 4 mars 2006,

Duke përkujtuar Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2004/2 të datës 9 shkurt 2004 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/49 mbi themelimin e Departamentit administrativ të shërbimeve publike komunale,

Me qëllim të shkarkimit të shërbimeve publike komunale nga borxhet e papaguara në pronën që është nën administrim të Agjencisë Kosovare të Pronës,

Me anë të kësaj shpall këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1
Përkufizimet

“Borxh” do të thotë pagesat që duhet bërë për shërbimet publike komunale që janë ofruar në pronën që është apo ka qenë nën administrim të Agjencisë Kosovare të Pronës, të cilat borxhe janë bërë gjatë të gjitha periudhave të mëparshme të banimit nga persona të tjerë përveç bartësit të së drejtë pronësore të pronës në fjalë, dhe të cilat duhet paguar ofruesit të shërbimeve publike

komunale. Kjo përfshin periudhat e banimit të paligjshëm dhe periudhat e banimit të ligjshëm nga persona të tjerë përveç bartësi të së drejtës pronësore, sipas skemës së qiradhënies të Agjencisë Kosovare të Pronës,

“Kontratë për qira” do të thotë kontratë në mes të Agjencisë Kosovare të Pronës në emër të bartësit të së drejtës pronësore dhe qiramarrësit,

“Pronë” do të thotë pronë banesore shoqërore apo publike; ose pasuri e paluajtshme private, duke përfshirë edhe pronën bujqësore dhe komerciale,

“E drejtë pronësore” do të thotë çdo e drejtë në pronësi, në posedim të ligjshëm, e drejtë për shfrytëzim ose e drejtë për zotërim të pronës.

Neni 2 Përfshirja

2.1. Kur ekziston një borxh i papaguar për shërbime publike komunale, ku përfshihet prona e cila ka qenë apo është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës, dhe ky borxh ka të bëjë me një periudhë të banimit të paligjshëm ose me një periudhë të banimit të ligjshëm nga një person tjetër përveç bartësit të së drejtës pronësore, sipas skemës së qiradhënies të Agjencisë Kosovare të Pronës, borxhin e tillë ofruesi i shërbimeve publike nuk kërkon ta paguaj apo grumbullojë nga personi i cili nga Agjencia Kosovare e Pronës konstatohet se është bartësi i së drejtës pronësore, të cilin borxh ia riorienton uzurpatorit, pasi që nga Agjencia Kosovare e Pronës të merr:

- (1) Vendimin e Drejtoratit të çështjeve banesore pronësore, vendimin e Komisionit të ankesave për çështje banesore pronësore, një vendim nga Agjencia Kosovare e Pronës ose vendim nga Komisioni i ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës, në të cilin janë specifikuar datat e uzurpimit nga personi (at) përveç bartësit të së drejtës pronësore ose
- (2) Një dokument nga Agjencia Kosovare e Pronës, në të cilin specifikohet periudha kur prona në fjalë ka qenë nën administrimin e Agjencisë ose e banuar nga një person përveç bartësit të së drejtës pronësore sipas një kontrate qiraje, bazuar në skemën e qiradhënies të Agjencisë Kosovare të Pronës.

2.2 Agjencia Kosovare e Pronës do t’i sigurojë ofruesit të shërbimeve publike komunale çdo informacion relevant që mund ta ketë, për t’i mundësuar atij që të identifikojë banuesin i cili është përgjegjës për borxhet e papaguara lidhur me pronën në fjalë.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 5 maj 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm